



C.nr.71/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padinë e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Viti, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Prishtinë, të cilën me autorizime përfaqëson [REDACTED] nga avokatura shtetërore, për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale të parealizuara, në seancën e mbajtur me datë 05.11.2018 ka marrë këtë:

### A K T G J Y K I M

*- në bazë të pohimit -*

**I. APROVOHET** në tërësi, padia dhe kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Viti, e ushtruar kundër të paditures Ministria e Punëve të Brendshme-Prishtinë.

**II. ANULOHET** Vendimi nr.651 i datës 05.08.2010 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe Vendimin P.nr.051/VDP/2010 të datë 25.06.2010 i lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, të vërtetuar me vendimet gjyqësore të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.302/13 i datës 14.01.2014, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit AC.nr.709/2014 i datë 11.01.2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.80/2017 i datë 10.10.2017.

**III. OBLIGOHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, që paditësin [REDACTED] ta kthej në vendin e punës dhe në pozitën e punës, ekuiivalent me pregaditjen profesionale-shkollore, sipas nevojave operative në Policin e Kosovës, dhe atë me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

**IV. DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, që paditësit [REDACTED] t'ia bëjë kompensimin e të ardhurave personale-mujore të pa-realizuara, duke filluar prej muajit Gusht të vitit 2010 e deri në muajin Tetor 2018, në shumë të përgjithshme prej **43,438.00 €** (*katërdhjetë-e-tremijë-e-katërqind-e-tridhjetë-e-tetë-euro*), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

**V.** Secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

## Arsyetimi

Paditësi [REDACTED], me datë 09.12.2013 ka paraqitur padi kundër Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës, për anulimin e vendimit nr.651 të dt.05.08.2010 dhe kthimin në vendin e punës si dhe kompensimin e të ardhurave personale të pa-realizuara si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Paditësi në padi dhe në precizim të padisë, dhe gjatë sancave të mbajtura, përmes të autorizuarit të tij, ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së ushtruar pranë kësaj gjykate, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj vendimin nr.651 të datë 05.08.2010 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, po ashtu ta anuloj Vendimin P.nr.051/VDP/2010 të datë 25.06.2010 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, dhe ta anuloj rekomandimin nr.288 të datë 06.04.2010 i lëshuar nga Komisioni për Emërimet e Larta dhe Diciplinë së Polici dhe njëherit të obligohet e paditura që paditësin ta kthej në vendin e punës, në pozitën e punën në të cilën ka qenë para largimit nga marrëdhënia e punës, me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, përfshirë edhe kompensimin e të ardhurave personale të pa-realizuara gjatë periudhës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Sipas të autorizuarit të paditësit, pretendimet e paditësit në kërkesëpadi për kthim në vend pune dhe kompensim të pagave të pa realizuara bazohet në faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, fakt që është vërtetuar me vendimet gjyqësore të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.302/13 i datës 14.01.2014, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit AC.nr.709/2014 i datë 11.01.2017 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.80/2017 i datë 10.10.2017, si dhe me vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerrura në procedurë penale, e sidomos me vendimin e Gjykatës së Qarkut P.nr.146/10 i dt.07.02.2011 me të cilën është pushuar procedura pénale ndaj paditësit [REDACTED].

I autorizuari i paditësit në seancën e fundit si dhe në fjalën përfundimtare e ka specifikuar lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket pagave të pa realizuara dhe atë si në vijim: prej muajit gusht 2010 deri në muajin shkurt 2011 gjithësej 7 muaj x 280.00 € = 1,960.00 €; nga marsi 2011 deri në mars 2013 gjithësej 37 muaj x 392.00 € = 14,504.00 €; nga prilli 2014 deri në dhjetor 2017 gjithësej 45 muaj x 490.00 € = 22,050.00 €; nga janari 2018 deri tetor 2018 gjithësej 10 muaj x 509.60 € - 5,096.00 €, që në shumë totale, pas llogaritjes së zbritshmërisë së trustit, borgji total në emër të pagave të pa realizuara kap shumën prej 43,438.00 €, të cilën shumë kërkon t'i paguhet nga e paditura brenda afatit prej 30 ditësh. Njëherit i autorizuari i paditësit, ka deklaruar se heqë dorë nga kërkesa për pagesën e rrezikshmërisë, heqë dorë nga kamata dhe nga pagimi i trustit si dhe nga pagimi i shpenzimeve të procedurës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditures në seancë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshtoj kërkesëpadinë e paditësit për kthim në vendin e punës, ekuivalent me përgaditjen e tij shkollorë dhe gradën të cilën e ka mbajtur deri në largimin nga puna, me që paditësi ka hequr dorë nga pagesa e rrezikshmërisë, kamata dhe nga shpenzimet e procedurës, i propozoj gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke e kthyer paditësin në vendin e punës dhe duke i'na kompenzuar pagat e pa realizuara në shumën siç e precizoit në këtë seancë, pra shumën prej 43,438.00 €, poashtu nuk ka kundërshtuar që pagesa të bëhet brenda afatit prej 30 ditësh.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së faktave të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse përbushin detyrimin e tyre për t'i parashtuar ato, në kutpim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës sin ë vijim aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.302/13 i datës 14.01.2014, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit AC.nr.709/2014 i datë 11.01.2017 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.80/2017 i datë 10.10.2017, dhe pas analizimit të provave dhe thënieve të palëve ndërgjygjëse në këtë procedurë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit nuk është kontestuese nga pala e paditur dhe njëherit kërkesëpadia nuk është në kundërshtim me faktet dhe provat e paraqitura nga paditësi dhe të pohuara nga pala e paditur, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, ndaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, (*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejmë, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).*)

Nga të lartë cekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 148 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur konform nenin 450 të LPK-së, pasi që pala paditëse ka hequr dorë nga kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.71/17 datë 05.11.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
OPLUKA JE PRVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II / UROSEVAC

Më  
Dana

21.11.2018



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjës së tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.